



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:169436

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05513630

CN.nr.60/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Besmir Juniku, sipas lëndës jo kontestimore të propozuesve A.I.E dhe S.I.E, që të dy nga Rahoveci, të cilët me autorizim i përfaqëson Av.J.B nga Rahoveci, ndaj kundërpropozuesve N, B dhe M.V, që të tre nga Rahoveci, për shkak të rregullimit të megjëve, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe matjes në terren, me datë **27.03.2024** merr këtë:

A K T V E N D I M

I.REGULLOHEN MEGJËT-kufiri në mes parcelave numër 5576-3, në vendin e quajtur "Bugarska Çesma", me kulturë "Infrastrukturë-rrugë", me sipërfaqe prej 112m², numër 5576-1, në vendin e quajtur "Bugarska Çesma", me kulturë "Tokë ndërtimore", e kl. 1, me sipërfaqe prej 700m², që të dyja në Zonën Kadastrale Rahovec, në posedim të propozuesve A.E dhe S.E, me parcelat me numër 5577-9, në vendin e quajtur "Bugarska Çesma", me kulturë "Tokë ndërtimore", me sipërfaqe prej 342m², në posedim të kundërpropozuesit N.V, parcelës me numër 5577-10, në vendin e quajtur "Bugarska Çesma", me kulturë "Tokë ndërtimore", me sipërfaqe prej 342m², në posedim të kundërpropozuesit B.V dhe parcela me numër 5577-11, në vendin e quajtur "Bugarska Çesma", me kulturë "Tokë ndërtimore", me sipërfaqe prej 395m², në posedim të kundërpropozuesit M.V, që të gjitha parcelat në Zonën Kadastrale Rahovec, ashtu që megjë të ndërmjet këtyre parcelave rregullohen në mënyrën si në vijim: megja e parë (me koordinata Y7471760.10 dhe X4694866.83) është e vendosur në trekufirin e parcelave kadastrale: numër 5576-3 dhe parcelës numër 5577-9. Prej megjës së parë vija kufitare shkon në drejtim të lindjes në gjatësi prej 22.50m, ndërsa megja e dytë (me koordinata Y7471782.41 dhe X4694863.90) është e vendosur në mes të parcelës me numër 5576-3 dhe 5577-9, ashtu që prej megjës së dytë vija e kufirit vazhdon në drejtim të lindjes në gjatësi prej 6.19m. Megja e tretë (me koordinata Y7471788.55 dhe X4694863.10) është e vendosur në trekufirin e parcelave me numër 5576-3, 5576-1 dhe 5577-10, e cila vazhdon në drejtim të lindjes në gjatësi prej 8.50m. Megja e katërt (me koordinata Y7471796.98 dhe X4694861.99) është e vendosur në mes të parcelës me numër 5576-1 dhe 5577-10, e cila vazhdon në drejtim të lindjes në gjatësi prej 7.81m. Megja e pestë (me koordinata Y7471804.76 dhe X4694861.36) është e vendosur në trekufirin e parcelave me numër 5576-1, 5577-10 dhe 5577-11, e cila vazhdon në drejtim të lindjes në gjatësi prej 21.50m dhe megja e gjashtë (me koordinata Y7471826.19 dhe X4694859.64) është e vendosur në mes të parcelave me numër 5576-1 dhe 5577-11, që të gjitha parcelat në ZK Rahovec.

II. Megjët si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi janë vendosur me kunjë - shufra metalike dhe të ngjyrosur me ngjyrë të kuqe, matjet janë bërë duke i shfrytëzuar elaborati kadastral të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale Rahovec, ndërsa piketimi është bërë me GPS dhe metodën e matjeve ortogonale.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit A.I.E dhe S.I.E, që të dy nga Rahoveci, përmes të autorizuarit Av.J.B në këtë gjykatë kanë paraqitur propozim për rregullimin e megjëve (pikave kufitare të tokave) në mes të parcelave në posedim të tyre, me parcelat në posedim të kundërpropozuesve N, B dhe M.V, që të tre nga Rahoveci.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka caktuar ekspertizën e gjeodezisë dhe së bashku me palët ndërgjyqëse dhe ekspertin Shaban Hoti ka dalë në vend për të vendosur megjët.

I autorizuari i propozuesve Av.J.B në propozim, gjatë shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar: mbetet në tërësi pranë propozimit për rregullimin e megjëve, ekspertizën e gjeodezisë të datës 17.01.2024, dhe plotësimin e saj të përpiluar nga eksperti Shaban Hoti, i kemi pranuar me kohë dhe ndaj kësaj ekspertize nuk kemi vërejtje, pajtohem në tërësi me vendosjen e megjëve të përshkruara si në ekspertizë. I propozoj gjykatës që të nxjerrë vendim dhe ti caktojë megjët duke u bazuar në ekspertizën e gjeodezisë.

Kundërpropozuesi B.V ka deklaruar se: pajtohet që të caktohet eksperti i gjeodezisë, si dhe të dilet në vend me gjykatën, ekspertin dhe palët për t'i vendosur megjët, duke shtuar se ekspertizën e gjeodezisë me plotësimet e saj i kemi pranuar me kohë, ndaj kësaj ekspertize nuk kemi vërejtje, jemi pajtuar në tërësi me mënyrën e vendosjes së megjëve edhe në terren edhe në bazë të ekspertizës, andaj pajtohem që gjykata të vendosë, të nxjerrë vendim dhe ti caktojë megjët duke u bazuar në këtë ekspertizë.

Kundërpropozuesi N.V ka ndryshuar adresë dhe për këtë nuk e ka njoftuar gjykatën, andaj gjykata konform nenit 116 të LPK-së, komunikimin me kundërpropozuesit N e ka bërë përmes tabelës së shpalljeve të gjykatës, përmes të cilës të njëjtit në mënyrë të rregullt i është dorëzuar ekspertiza e gjeodezisë me plotësimet e saj dhe ftesa për seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.03.2024, në të cilën kundërpropozuesi nuk ka prezentuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Po ashtu kundërpropozuesi M.V e ka pranuar ekspertizën e gjeodezisë me plotësimet e saj, si dhe ftesën për seancë, ndërsa në shqyrtimin kryesor të datës 27.03.2024 nuk ka prezentuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Gjykata shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesë të kundërpropozuesve Neki dhe M.V konform nenit 3 të LPJK-së lidhur me nenin 423.4 të LPK-së.

Pas matjes dhe llogaritjes nga ana e ekspertit janë vendosur 6 (gjashtë) megjët me kunjë - shufra metalike dhe me ngjyrë të kuqe, të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Palët ndërgjyqëse e kanë pranuar ekspertizën gjeodezisë me plotësimet e saj (me skicë të terrenit) të datës 17.01.2024, dhe lidhur me këtë nuk kanë shprehur ndonjë vërejtje në vendosjen e megjëve nga ana e ekspertit të gjeodezisë.

Gjykata në tërësi e ka përkrahur ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë të dhënë me ndërgjegje dhe në mënyrë profesionale, me të cilën gjendje secili pjesëmarrës e ka sipërfaqen sipas evidencës në kadastër.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, konform nenit 206 dhe 212 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore -LPJK është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në nenin 29.3 të LPJK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
CN.nr.60/2022, datë 27.03.2024

Gj y q t a r i
Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë–Divizioni Civil.